REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS-MINISTARSTVO OBRAZOVANJA I NAUKE-MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE
DALJE
Njësia org. 01 Data/Datum/Date 10.11.2026
Nr. Prot./Br./No. 6406 Nr. i faq./Br. str/No.pg 2
Prishtinë / Priština / Pristina

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke/Ministry of Education and Science

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Nr. 01/6406

Dt. 10-11-2026

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (G. Z. nr. 7/01 mars 2019, Prishtinë), nenit 53 te Ligjit Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nënparagrafi 1.5 i paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (G. Z. e Republikës së Kosovës /nr. 34/18 nëntor 2022, Prishtinë) si dhe neni 10 i Udhëzimi Administrativ Nr.03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative, nxjerrë;

V E N D I M

1. Anulohet Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2026 për Inicimin e Procedurës Disiplinore ndaj Personit Fizik të Punësuar në Institucionet Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (publike dhe private), si dhe për Ndalimin dhe Ndërprerjen e Punës së Personit Juridik.

2. Obligohet Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës pranë Zyrës së Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në kuadër të angazhimit të saj për garantimin e ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe funksionimit të rregullt institucional, pas shqyrtimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2026 për Inicimin e Procedurës Disiplinore ndaj Personit Fizik të Punësuar në Institucionet Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (publike dhe private), nga Departamenti Ligjor, ka vlerësuar të nevojshëm anulimin e tij.

Gjatë shqyrtimit është konstatuar se disa çështje të rregulluara me këtë akt kërkojnë qartësim dhe harmonizim të mëtejmë me legjislacionin në fuqi, veçanërisht lidhur me fushëveprimin dhe kompetencat institucionale për zhvillimin e procedurave disiplinore.

Andaj, me qëllim të garantimit të zbatimit të drejtë të legjislacionit, ruajtjes së parimit të ligjshmërisë dhe shmangies së paqartësive në ushtrimin e kompetencave të Ministrisë dhe Inspektoratit të Arsimit, u vlerësua i domosdoshëm anulimi i këtij akti, ndërsa rregullimi i mëtejmë i kësaj fushe do të bëhet në përputhje me autorizimet ligjore dhe kompetencat përkatëse. Prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabineti i Ministrit;
2. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MASH;
3. Gazetës Zyrtare/ZKM
4. Departamenti Ligjor në MASH;
5. Arkivit në MASH

Hajrulla Çeku

Ministër i Arsimit dhe Shkencës